



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Website: www.gjykata.gov.al

Adresa :Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan,Shqipëri.

PROGRAMI TRANSPARENCËS

ANEKS B. Indeks- Lidhja (1)

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të Ligj nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar, dhe Urdhër Nr 158 Prot., datë., 24.01.2024 "Për miratimin e Programit të Transparencës", shfuqizuar me Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 me objekt "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan", sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 të Rishikuar¹.

Programi i Transparencës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ka përmbajtjen sipas **Aneks A**, **Aneks B**, dhe publikohet në faqen zyrtare www.gjykata.gov.al në rubrikën "Programi Transparencës". Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së Autoritetit Publik këtu Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kuadër të Ligj nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar². Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndërton dhe rrit transparencën për veprimtarinë e saj institucionale, ne interest e publikut. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së³. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së Gjykatës nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje në mënyrë të vazhdueshme. Faqja zyrtare e e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

¹ Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 me objekt "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan" të publikohet si bashkëlidhje e këtij zëri në formt link në fund të referimit.

² (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit") (i përditësuar).

³ Ligj nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar. Neni5.2 Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave në përputhje me Ligj 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”⁴, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Gjykata ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e saj publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Gjykatës dhe përkatësisht: Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe të Paketës Ligjore të relatuar në lidhjen nr. 7 të Anek B të këtij Programi dhe jo vetëm.
4. Informacioni përshatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtëj e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;

⁴ Ky ligj është përafshuar plotësisht me:- rregulloren (BE) nr. 679/2016, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/EC, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 119/1, datë 4.5.2016.- direktivën nr. 680/2016, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente, me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e vendimit kornizë të Këshillit 2008/977/JHA, numri CELEX 32016L0680, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 119, datë 4.5.2016, f. 89.

- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar. Në përputhje me këtë Program Transparence të miratuar, vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.gjykata.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota të Paketës Ligjore Kombëtare dhe Ndërkombëtare, të vendimeve, udhëzimeve, akteve normative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Rregulloreve të Gjykatës, si edhe të Konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar⁵ dhe të Ligj Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” që kryhen për llogari të autoritetit publik” i ndryshuar⁶, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët

⁵Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 26.02.2021 Ligji nr. 16/2024, datë 8.2.2024 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 04.03.2024 Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 65–242;- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 243–374;- Direktivën e Këshillit 89/665/KE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënie të kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 395, datë 30.12.1989, f. 33–35;- Direktivën e Këshillit 92/13/KE, datë 25 shkurt 1992 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, e ndryshuar”.

⁶ Ligj Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” (ndryshuar me ligjet: nr. 88/2014, datë 17.7.2014; nr. 77/2015, datë 16.7.2015; nr. 50/2019, datë 18.7.2019; nr. 28/2024, datë 4.4.2024) (i përditësuar).

kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfutur ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohej i dobishëm nga autoriteti publik;

- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Autoritetit një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

- Autoriteti, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga DPD-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

4.TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë		Dokumenti/ përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrimi i strukturës organizative dhe i pagave të Gjykatës.	Neni 7/1/a/d	Skema e strukturës organizative.	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.	Në faqen zyrtare të www.gjkata.gov.al	Kryetari i Gjykatës. Koordinatori, Burimeve njëzore. Specialisti i IT.
Procedura e zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e funksionarëve të lartë të Gjykatës.		Struktura e pagave. (Publikim sipas modelit të depozituar bashkëlidhur për strukturën derim më Tetor 2025. Tabelë e funksioneve dhe e detyrave.	Menjëherë pas hyrjes në fuqi.	Rubrika "Programi i Transparencës" sipas referimit të zërave të programit të miratuar Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 me objektin "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të	
Procedura për të marrë vendime e funksionarëve të lartë të Gjykatës.		CV-të e funksionarëve të lartë. Bashkëlidhje CV` Ish Kryetarit z. Artur Prenga. Deri në përfundim të përditësimit të CV` sipas kërkesës së Koordinatorit për të Drejtën e Informimit Nr. 2201 Prot., më datë 12.11.2025. të vendoset	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari sipas Urdhër Nr. 38		

Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklaram.		bashkëlidhje e link https://www.aksesdrejtesi.al/persons/1 Ligj Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”(ndryshuar me ligj nr. 46/2021, date 23.03.2021); Vendim Nr. 149, datë 29.03.2023 “Për Miratimin e Rregullave Standarde për Organigramën, Përshkrimin e Detyrave dhe Përgjegjësi të Pozicioneve të Npunësve Civilë Gjyqësorë dhe Punonjësve Të Tjerë Të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kategoria e Dytë dhe e Tretë, pa Zyra Shërbimi”; Akte ligjore/nënligjore Vendime të KLGJ-së, sipas Paketës Ligjore të Aneks B Lidhja (7) të Programit të Transparencës. Vendime të Gjykatës Kushtetuese në vijëmisë gjatë përditësimit. Akte ligjore/nënligjore	datë 12.11.2025 me objekt “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” .	Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” Referenca në Aneks B.	
Konventa të ratifikuara, ligje, akte nënligjore, kodetë sjelljes, strategji, raporte vjetore dhe dokumente politikash, manuale dhe çdo dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Konventa, Ligje Akte nën ligjore të përcjella në Korrespondencën e IT për Paketën Ndërkombëtare sipas Urdhër Nr. 158 Prot.,datë 24.01.2024” “Për miratimin e Programit të Transparencës”, dhe Paketa Ligjore Kombëtare sipas të Aneks B të Lidhjes (7) të Programit të Transparencës së Rishikuar. të miratuar Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 me objekt “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” Shtohen Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” Rregullore Nr. 202 prot., datë 15.05.2023 “Mbi metodikën e punës arkivore të fondkrijuesve të sistemit të drejtësisë”.	Pas hyrjes në fuqi. Pas miratimit	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al “Programi i Transparencës” sipas referimit të zërave të programit të miratuar Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 me objekt “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” Referenca në Aneks B.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit Specialisti IT

		Ligj Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”(Ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024, datë 4.4.2024) (I përditësuar). Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligj 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Ligj nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në RSH”; Ligj nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr.162/2020, Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij (VKM, Udhëzime, etj.); - Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik” i ndryshuar; Rregullore Ligj Nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut Dhe Lirive Themelore Dhe Protokollet Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Tiranë, 2020. Ligj Nr.9590, datë 27.7.2006 “Për Ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare” Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut Kundër Shqipërisë 2010-2021,Vëllimi I 2010-2014Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Tiranë, 2022 Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Europiane Për Të Drejtat E Njeriut Kundër Shqipërisë 2010-2021 Vëllimi III 2020-2021 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Tiranë, 2022		
--	--	--	--	--

		Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut Kundër Shqipërisë 2010-2021 Vëllimi II 2015-2019 Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Tiranë, 2022 Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Europiane Për të Drejtat e Njeriut Kundër Shqipërisë Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Qershor 2010 Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Qershor 2010 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007; nr.9904, datë 21.4.2008; nr.88/2012, datë 18.9.2012, nr.137/2015, datë17.12.2015 dhe nr.76/2016, datë 22.7.2016). Ligj Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”(ndryshuar me ligj nr. 46/2021, date 23.03.2021); Ligj Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”(Shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, ndryshuar me ligjin nr.48/2019, datë 18.7.2019, nr. 15/2020, datë 12.2.2020; nr. 149/2020, datë 17.12.2020; nr. 50/2021, datë 23.3.2021; nr. 33/2023, datë 25.5.2023) (i përditësuar); Ligj Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 16.5.2017 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017, ndryshuar me ligjin nr. 47/2019, datë 18.7.2019) (i përditësuar); Ligj Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”) (i përditësuar); Ligj Nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;			
--	--	---	--	--	--

	Vendim Nr. 149, datë 29.03.2023 “Për Miratimin E Rregullave Standarde Për Organigramën, Përshkrimin E Detyrave Dhe Përgjegjësi Të Pozicioneve Të Nëpunësve Civilë Gjyqësorë Dhe Punonjësve Të Tjerë Të Gjykatave Të Shkallës Së Parë Të Juridiksionit Të Përgjithshëm, Kategoria E Dytë Dhe E Tretë, Pa Zyra Shërbimi”; Vendim Nr. 716, Datë 06.12.2023 “Për Miratimin e Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median.”; Udhëzim Nr. 85, datë 11.03.2021 “Procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”i Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendim Nr. 554, datë 29.12.2022 “Për Ndarjen me Short të Çështjeve Gjyqësore” i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vendim Nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” i Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendim Nr. 171, datë 22.04.2021 “Për Miratimin e “Kodi i Etikës Gjyqësore” të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Vendim Nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës” i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ligj Nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligj Nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik1” Lligj Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (Ndryshuar me ligjet nr. 178/2014, datë 18.12.2014 dhe nr. 41/2017, datë 30.3.2017) (i përditësuar)			
--	---	--	--	--

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Kthim përgjigje Refuzim i kërkesës Zgjatje e afatit të përgjigjes Etj. Të gjithë formularët e publikuar në zërin përkatës. Shtohen Formular Ankese dhe Intership. Materialet e Aneks B. Adresa postare: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.Lagjja “5 maji”, Rr. “Koço Brisku” Tel: 00355 (54) 25 99 51 Adresa e-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparencës me Urdhër Nr. 38 datë 12.11.2025 me objekt “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” Miratimit të Matelialeve të Aneks B. Menjëherë, në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “Programi i transparencës” - njoftime te tjera si dhe Koordinatori per te drejten e informimit.	Administrata e Gjykatës Koordinatori Specialisti IT
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Gjykatës, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/c/g	Adresa postare: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Manjola Kume. Lagjja “5 Maji”, Rr. “Koço Brisku” Tel: 00355 (54) 25 99 51 Email: manjola.kume@gjykata.gov.al Orari: nga dita e Hënë - e Premte, në orarin 08:00 -16:00.	Sipas Vendim Nr. 288 Prot., datë 18.12.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me objekt: “ Për përcaktimin e Kooridnatorit për të Drejtën e Informimit” znj. Manjola Kume	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “Gjykata”- Shkallës Parë e Juridiksionit të Përgjishtëm Elbasan	Kyeta i Gjykatës, Këshilli i Gjykatës

Mekanizmat monitorues, plane strategjike, raporte audit, dokumenta tregues të performacës	Neni 7/1/d h	Analiza vjetore e punës Raporte monitorimi dhe auditimi nga KLSH dhe KLGJ. Indekset e Komisionerit për të Drejtën e Informimit mbi monitorimin e transparencës së institucionit për Raportet e Monitorimit. Relacion për Realizimin dhe Mosrealizimin e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendim nr. 590 datë 26.11.2020	Përditësim periodik	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “Programi i Transparences”	Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Koordinatori Specialisti It
Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.	Neni 7/1/e	Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, nr. 14/2023, datë 16.2.2023) Ligji Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Udhëzimi Nr. 39 datë 24.12.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018”. Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Ligj Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat“ që kryhen për llogari të autoritetit publik” i ndryshuar. Ligj nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në RSH”. Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.	Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “Programi i transparences” .	Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

		Ligji nr.162/2020, Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij (VKM, Udhëzime, etj.); - Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë", i ndryshuar. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij (VKM, Udhëzime, etj.); Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;			
Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit .	Neni 7/1/f	Ligj Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Ligj Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020” “Për prokurimin publik” dhe të Ligj Nr. 125/2013 ndryshuar me Ligjin Nr.88/2014 Ligjin Nr.77/2015 Ligjin Nr.50, datë 18.07.2019 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat“ Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike Regjistri i realizimeve të prokurimeve publike	Menjëherë pas dërgimit në Agjencinë së Prokurimit Publik	Në faqen e zyrtare në menu-në:Programi i Transparencës – Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: www.app.gov.al	Stafi Drejtues i Gjykatës Zyra e Degës së Buxhetit Nëpunësi përgjegjës
Shërbimet për publikun.	Neni 7/1/f	Vërtetime, Ankime, ,Kopje aktesh/dokumentesh, Kërkesë padi, Vendime, Kërkesa për informacion etj.	Përditësohen sipas ndryshimeve ligjore	Në faqen zyrtare www.gjykata.gov.al	Kancelari i Gjykatës, Punonjësi i IT
Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e	Neni 7/1/gj	Projekt akte Dhënie mendimi	Përditësohet	Në faqen e zyrtare www.gjykata.gov.al	Kryetari i Gjykatës

Interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Gjykatës.					Këshilli i Gjykatës Koordinatori për të Drejtën e Informimit
Mbajtja e dokumentacionit nga Gjykata e Sjkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	Neni 7/1/h	Ruajtja e dokumentacionit në sistemin arkivor të institucionit bëhet në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor. Rregullore Nr. 202 Prot., Datë 15.05.2023 “Mbi metodikën e punës arkivore të fondkrijuesve të sistemit të drejtësisë:” Ligji Nr.9154, datë 06.11.2003 - Për Arkivat (Ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024, datë 4.4.2024)etj.	Përditësohet	Arkiva Fizike në Gjykatë dhe faqe zyrtare www.gjykata.gov.al	Arkivi/Protokolli.
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 119/2014	Neni 7/1/i	Tabelat Ligj Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”) (i përditësuar); Ligj Nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”; Vendim Nr. 716, Datë 06.12.2023 “Për Miratimin e Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median.”; Rregullore be 679/2016 DPR_shqip Konventa e Tromso etj.	Pas miratimit të programit të transparencës.	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “Programi i transparencës” – “Regjistri i kërkesave dhe i përgjigjeve”.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit. Specialisti IT.
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Datat e gjykimeve, Vendime gjyqësore, Vërtetime civile dhe penale, Statistika, informacion mbi statusin e gjykimit, shorti elektronik etj.	Përditësohen	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “Kalendari i seancave”	Administrata e Gjykatës Specialisti It

				“Informacion mbi shortin”, Statistika: etj	
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/1	Njoftime me afishim publik Njoftime Pasqyra Shtypit	Përditësohen periodikisht	Në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al Rubrika “ Njoftime të Tjera” “Pasqyra e shtypit” “Shpallje publike” etj.	Administrata e Gjykatës Specialisti It Koordinatori për të drejtën e informimit

5.PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Gjykata vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.gjykata.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme në një menu të veçantë të titulluar “Programi i transparencës”.

6.MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

Faleminderit,

Miratoi

**ZV/KRYETAR
Z. ELIS DINE**

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**



